

Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë,02.06.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 29.05.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "**Qendra për trajnimin ekafsheve SHPK.**", per aktivitetin: "**Trajtimi i qeneve endacak Nr. të Prok: 616 21 043 221 nxjerr:**

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "**Qendra për trajnimin ekafsheve SHPK.**", per aktivitetin: "**Trajtimi i qeneve endacak Nr. të Prok: 616 21 043 221**", kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit , të datës 24.05.2021 të publikuara ne web-faqe te KRPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj aktivitetin sipas publikimit te Vendimit të AK-së të datës 24.05.2021.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik **“Qendra per trajnimin e kafsheve SHPK., ”** me datë 29.05.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Trajtimi i qeneve endacak Nr. të Prok: 616 21 043 221**

Autoriteti Kontraktues, me datë 02.06.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi se eshte dashte t’iu kerkohen sqarime shtese per licence nuk qendron per arsye se licenca jo vetem qe ishte me afat te skaduar,por ishte e leshuar ne emer te nje OE-ik tjetër’AV Medical”nga Obiliqi dhe nuk kishte asnje nderlidhje me kompanine tuaj dhe me veterinarian e prezentuar,


-pretendimet se i jane kerkuar sqarime tenbderuesit te rekomanduar me kontrate ne kundershtim me nenein 72 poashtu nuk qendron,sepse eshte kerkuar sqarim plotesues per dokumentat qe kane qene pjese valide e tenderit te tij,pra nuk kemi te bejme me asnje plotesim te tenderit,por vetem me sqarime qe nderlidhen me dokumentet e dorezuara dhe poashtu ne baze te sqarimit professional nga Avuk-u.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit